



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/133
Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/04 të datës 11.03. 2011

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 02/04 i datës 11.03. 2011, për themelimin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike.
2. Pika 2. e vendimit nr.02/04 të datës 11.03.2011, zëvendësohet me tekstin si në vijim:

2.1. Fadil Ismajli, Ministër i Zhvillimit Ekonomik,	kryesues;
2.2. Besim Beqaj, Ministër i Financave,	anëtar;
2.3. Mimoza Kusari-Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë,	anëtare;
2.4. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenës Sociale,	anëtar;
2.5. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	anëtar;
3. Pika 3. e vendimit nr.02/04 të datës 11.03.2011, zëvendësohet me tekstin si në vijim: "Komisioni Qeveritar do të vazhdoj monitorimin në procesin e post-privatizimit të kompanisë, distribuicionit dhe furnizimit me energji elektrike"

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë